

**VENDIM**  
**Nr.379, datë 31.5.2005**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË  
PALUAJTSHME, SHTËPI BANIMI, E CILA RREZIKOHET NGA LINJA E TENSIONIT TË  
LARTË 400 KV, ELBASAN-KUFI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 8, shkronja “ë”, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, shtëpi banimi, e cila rrezikohet nga linja e tensionit të lartë 400 kV, Elbasan-Kufi, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekësh, për shtëpinë e banimit me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>.

4. Shpenzimet procedurale për realizimin e shpronësimit janë në shumën 103 000 (njëqind e tre mijë) lekë.

5. Fondi prej 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekësh, për shpronësimin e pronarit, dhe fondi prej 103 000 (njëqind e tre mijë) lekësh, për shpenzimet procedurale, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, zëri “Kosto lokale për shpronësimet” i KESH sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit qershor 2005.

7. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, të kryejë çregjistrimin e shtëpisë, brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, KESH sh.a. dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË VENDNDODHJES SË BANESES  
SË TYRE BRENDË ZONËS MBROJTËSE TË LINJËS TË TENSIONIT TË LARTË 400 KV  
ELBASAN-KUFI

Rrethi: Librazh

Fshati: Vulçan

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: shtëpi banimi

| Nr | Emri   | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë që shpronësohet | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Sasia në m <sup>2</sup> | Çmimi në lekë/m <sup>2</sup> | Vlera e kompensimit në lekë | Adresa          |
|----|--------|--------|---------|----------------------------------|-----------------|------------------|-------------------------|------------------------------|-----------------------------|-----------------|
| 1  | Reshit | Arif   | Stafa   | Shtëpi banimi                    | 3843            | 407/1            | 96                      | 15 000                       | 1 440 000                   | Vulçan-Librazhd |
|    | Totali |        |         |                                  |                 |                  |                         |                              | 1 440 000                   |                 |

Sqarime: Shpezimet procedurale:

1. Publikime, 78 000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë.

2. Shpërblim i anëtarëve të komisionit, 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Vlefë totale e shpronësimit=1 440 000+103 000=1 543 000 lekë.